



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.94/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR, dega në Pejë, për shkak të vendosjes së materialeve zgjedhore në hapësirë publike-drunjë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dhe Koalicionit LDK-AKR, dega në Pejë i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2,600.00 (*dymijë e gjashtëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 në sheshin “Mbretëresha Teutë” në Pejë, aktivisti i tyre ka vërejtur se në hapësirë publike-drunjë ishte vendosur materialet zgjedhore si posteret e kandidatëve për deputete dhe njoftimi për tubim i po të njëjtë Koalicion LDK-AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.06.2017, Koalicioni LDK-AKR theksojnë se pas pranimit Urdhrit për Përmirësim nga ana e PZAP-it, kanë urdhëruar degën në Pejë që të ndërmerrë veprime përmirësuese me çka është evituar shkelja, pas përfundimit të tubimit duke larguar njoftimin për tubim. Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim te nenin 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se materialet zgjedhore si njoftimi dhe posterët e kandidatëve për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit LDK-AKR janë vendosur në hapësira publike-drunjë, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR janë vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.


Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe e njëjtë shkelje është përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor nga koalicioni LDK-AKR ngase materiali zgjedhor si njoftimi për tubim dhe posterët e kandidatëve për deputet nga janë vendosur në hapësirë publike-drunjë që është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektit Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Po ashtu, paneli me rastin e vendosjes mori parasysh përpjekjet nga koalicioni LDK-AKR për të përmirësuar shkeljet duke i larguar posterët nga vendi ku ishin të vendosur, pasi që paneli e kishte urdhëruar koalicionin në fjalë që të largon posterët nga vendi ku ishte e ndaluar vendosja e të njëjtëve. Veprimet të cilat paneli i mori parasysh gjatë vendimmarjes e që ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr.94/2017 më datën 09.06.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.